

# Si ndikon në inflacion kontrolli i çmimeve të produkteve?



—  
Nëntor 2022

Si ndikon në inflacion kontrolli  
i çmimeve të produkteve?

—  
Nëntor 2022

— **Përmbajtja**

Përmbledhje ekzekutive	3
1. Hyrje	4
2. Kontrolli i çmimeve të produkteve	6
3. Ndërhyrja e Qeverisë së Kosovës për të luftuar inflacionin	11
Përfundim	18
Aneks	19

## Përmbledhje ekzekutive

Si shumë vende tjera, edhe Kosova, gjatë këtij viti po përballet me rritje të theksuar të çmimeve. Rënia e ofertës në tregjet ndërkombëtare, mungesa e kapaciteteve prodhuese të brendshme dhe rritja e ndjeshme e kërkesës janë ndër shkaktarët kryesorë për këtë situatë. Në disa shtete, shkalla e matur e inflacionit përgjatë disa muajve të vitit 2022, ishte më e larta në 40 vitet e fundit. Në Kosovë, nga muaji mars i këtij viti, shkalla e inflacionit ka vlera dyshifrore dhe në shtator kjo shkallë ishte 12.7%. Kjo situatë po e rëndon jetën e qytetarëve. Për një familje me të hyra mujore prej 400 euro, në periudhën shtator 2021-shtator 2022, shpenzimi për blerjen e produkteve të njëjta ushqimore është rritur për rreth 28 euro apo 17%, për transport për rreth 6 euro apo 9%, për mjetet e komunikimit për 2 euro apo 15%, etj.

Gjatë dimrit të këtij viti, sfidë pritet të jetë dhe furnizimi me energji elektrike duke marrë parasysh dallimin e theksuar mes kapacitetit prodhues të Kosovës dhe konsumit të lartë gjatë dimrit, si dhe çmimet tejet të larta të importit të energjisë elektrike. Deri më tani, ndërhyrja e Qeverisë së Kosovës ka qenë kryesisht e fokusuar në orientimin e ndihmës tek kategoritë me më shumë nevojë, subvencionim të energjisë elektrike si burim i rritjes së mëtutjeshme të çmimeve të produkteve tjera, si dhe kontrolli i çmimeve të naftës përmes përcaktimit të marzhës së fitimit. Së fundmi, Qeveria ka propozuar Projektligjin për masat e përkohshme të produkteve themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg, përmes të cilit po synohet të rregullohen edhe çmimet e produkteve tjera të shportës bazë të cilat kanë pësuar rritje të ndjeshme. I njëjti është aprovuar në lexim të dytë në Kuvend më 8 nëntor 2022.

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se gjatë kohës së kontrollit të çmimit të naftës vërehet një lëvizje më e sinkronizuar e çmimit të naftës me pakicë në Kosovë dhe asaj në berzë. Ndërkaq, në kohën kur çmimet e naftës janë të parregulluara vërehet një tendencë e menjëhershme e rritjes së marzhës së fitimit nga naftëtarët dhe sinkronizim i vonuar me çmimet në berzë.

Nëse problemi me inflacionin shndërrohet në problem afatgjatë, politika e kontrollit të çmimeve mund të dëmtojë sektorët e ndikuar, siç tregojnë gjetjet nga vendet e tjera të cilat kanë aplikuar masa të ngjashme. Me Ligjin për masat e përkohshme të produkteve themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg dhe udhëzimet administrative për kontrollimin e çmimeve të naftës, do të preken sektorë që së bashku kanë qarkulluar mbi 1.1 miliard euro në vitin 2021 apo sa rreth 15% e BPV për atë vit. Praktikrat e vendeve tjera tregojnë që kontrolli i çmimeve si instrument për uljen e inflacionit është jo-efektiv, meqë pas heqjes së kufizimeve, çmimet kanë tendencë të rriten menjëherë.

Zbatimi i formave tjera të ndihmës ndaj qytetarëve, siç propozohet në diskutimet publike në Kosovë, që kryesisht parashohin uljen e normave tatimore ose heqjen e TVSH dhe akcizës për disa produkte, mund të ketë ndikim buxhetor nga 205 deri 246 milionë euro në gjashtë muaj apo rreth 455 milionë euro në vit. Ndër problemet kryesore me politika të tilla mbetet targetimi jo adekuat, si dhe të njëjtat ndikojnë në rritje artificiale të konsumit.


# 1. Hyrje

Gjatë vitit 2022, shtetet, duke përfshirë Kosovën, janë duke u përballur me rritje të ndjeshme të çmimeve. Fillimisht, çrregullimet në zinxhirin e furnizimit për shkak të pandemisë që u shpërfaqën pas rritjes së theksuar së kërkesës gjatë vitit 2021 me hapjen e ekonomive, si dhe lufta në Ukrainë, kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e inflacionit.<sup>1</sup> Por, ka edhe ngjarje tjera që e kanë goditur pjesën e ofertës në vijimësi, sikurse një mbyllje tjetër 70 ditore e Kinës gjatë vitit 2022, me synimin e qeverisë kineze që të ulet në zero numri i rasteve më COVID-19, tensionet mes Kinës dhe Taivanit, kushtet meteorologjike që kanë ndikuar në rënien e prodhimit të energjisë, etj.<sup>2</sup> Në disa shtete, shkalla e matur e inflacionit në disa muaj të vitit 2022, ishte më e larta në 40 vitet e fundit.<sup>3</sup> Në Kosovë, në muajin shtator të këtij viti, shkalla e inflacionit ishte 12.7%, ku që nga muaji mars, inflacioni kishte vlera dyshifrore.<sup>4</sup>

Rritja e çmimeve në botë, kryesisht buron nga një rritje e ndjeshme e çmimeve të energjisë elektrike, naftës dhe disa produkteve bazë sikurse miellit, vajit etj. Në shumicën e rasteve, këto rritje janë bartur në formë zinxhirore nga furnizuesit, shitësit e produkteve dhe ofruesit e shërbimeve tek konsumatorët, duke ndikuar në rritje të shumë çmimeve në treg. Një ndryshim i këtyllë është prezent edhe në Kosovë, përveç në rastin e energjisë elektrike, ku deri më tani nuk është bërë ngritje e çmimit për bizneset, për shkak të subvencionimit të tarifave nga ana e Qeverisë, ndërsa janë subvencionuar pjesërisht edhe tarifatat e energjisë elektrike për të gjithë qytetarët.

Për një familje me të hyra mujore prej 400 euro, shpenzimi për blerjen e produkteve të njëjta ushqimore është rritur për rreth 28 euro apo 17% për periudhën shtator 2021-shtator 2022, ndërkaq ato për transport për rreth 6 euro apo 9%, për mjetet e komunikimit për 2 euro apo 15% etj.<sup>5</sup> Në ekonomitë më të zhvilluara, parashikimet janë që shkalla mesatare e inflacionit në vitin 2022 të jetë rreth 6.6%, ndërsa tek vendet në zhvillim rreth 9.5%.<sup>6</sup>

**Figura 1.** Kosto e blerjes së shportës me artikuj të njëjtë në Kosovë, janar 2021-shtator 2022



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e ASK

1 United Nations. Global Impact of war in Ukraine on food, energy and finance systems. Burimi: <https://bit.ly/3S76JqH>

2 Bloomberg. Burimi: <https://bit.ly/3fpAHln>

3 Reuters. Burimi: <https://reut.rs/3StHD5j>

4 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3Cw09Um>


5 Bazuar në peshën që secila kategori ka tek shporta bazike e konsumit për secilin vit bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK).

6 FMN. Burimi: <https://bit.ly/3dxTuAi>

Ngjashëm sikur në vitet 2020 dhe 2021, kur ishte kërkuar ndërhyrja e qeverive për të ndihmuar me rimëkëmbjen ekonomike nga pandemia<sup>7</sup> (ku pako të tilla zbatohen ende edhe në Kosovë), është bërë e pashmangshme ndërhyrja e sërishme e qeverive, tani për të ndihmuar në tejkalimin e situatës me çmimet e ngritura.

Në kohën para rritjes së shpejtë të inflacionit, një debat i zhvilluar fillimisht mes ekonomistëve ishte nëse mund të ketë inflacion pas pandemisë COVID-19<sup>8</sup>, ndërsa tani, debati po zhvillohet kryesisht rreth asaj, nëse inflacioni do të jetë kalimtar, nëse mund ta ketë arritur majën e tij<sup>9</sup>, apo nëse do të jetë afatgjatë. Aktualisht, në berzë vërehet një tendencë e rënies së çmimeve për shumë produkte bazë dhe kthimit të tyre në nivelin që e kishin gjatë vitit 2021. Indeksi i çmimeve të ushqimit i hartuar nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara (ang: FAO) ka pësuar rënie për të pestin muaj me radhë.<sup>10</sup> Për produkte të caktuara, sikurse vajërat ushqimore, rënia gjatë muajit gusht krahasuar me muajin mars, kur ngritja e çmimeve ishte ndër më të lartat, është mbi 35%. Por, një tendencë e tillë është veçmas më e theksuar tek shtetet të cilat kanë kapacitete të zhvilluara prodhuese dhe janë eksportuese neto në ndonjërin apo disa nga sektorët që janë nxitës të krizës së çmimeve.<sup>11</sup>

**Figura 2.** Indeksi i produkteve bazike të FAO, 2014–2016=100



Burimi: FAO

Edhe çmimet e naftës në berzë kanë pësuar rënie në periudhën mars-shtator 2022, veçmas pas muajit korrik, rënia ka qenë e vazhdueshme (shih Figurën 3). Andaj, normalizimi i inflacionit aq sa varet nga politikat e ndërmarrura nga qeveritë, varet dhe nga vetë zhvillimet në treg, qoftë rritja e prodhimit të naftës

<sup>7</sup> Ndhima të cilat janë vlerësuar së kanë ndikuar në një masë në shkaktimin e inflacionit.

Shih: Lawrence H. Summers për Washington Post, 4 shkurt 2021. Burimi: <https://wapo.st/3fbHSmV>

<sup>8</sup> Po aty

<sup>9</sup> Bloomberg. Burimi: <https://bloom.bg/3dFUC4V>

<sup>10</sup> Agjencia e Ushqimit dhe Bujqësisë (ang: FAO). Burimi: <https://bit.ly/3SIWVcf>

<sup>11</sup> Project Syndicate. Burimi: <https://bit.ly/3DGy52F>

nga OPEC-u<sup>12</sup>, përfundimi i luftës në Ukrainë, rritja e prodhimit të produkteve bazë nga shumë shtete përnjëherësh, etj. Andaj, edhe ndërhyrja e shteteve me pako tejet të mëdha, që zgjasin me vite dhe që targetojnë kryesisht subvencionim të disa kategorive të përfituesve të skemave sociale, mund të jetë jo-adekuate. Gjithsesi, mbetet e paqartë se cila do të jetë dinamika e çmimeve të naftës sidomos gjatë muajve të dimrit, gjatë të cilës periudhë kërkesa për ngrohje dhe energji elektrike pritet të rritet ndjeshëm. Efekt negativ këtu mund të ketë dhe aspekti politik, ku vërehet një aleancë mes Arabisë Saudite dhe Rusisë që të mos rritet prodhimi i naftës.<sup>13</sup>

Sidoqoftë, ajo për çfarë ekziston një pajtueshmëri më e gjerë dhe se mbetet tejet e rëndësishme është që qeveritë duhet të ndryshojnë sjellje, duke u fokusuar në zbatimin e politikave që tentojnë të ulin inflacionin. Një shkallë e lartë e inflacionit e ndikon drejtpërdrejtë stabilitetin makroekonomik të tanishëm dhe atë afatgjatë. Mirëpo, ekzistojnë qasje të ndryshme sa i përket mënyrës së ndërhyrjes. Në njërën anë është një grup ekonomistësh dhe shtetesh që mëtojnë për ndërhyrje përmes instrumenteve që prekin të gjithë qytetarët, sikurse duke reduktuar normat tatimore. Një grup tjetër, kryesisht fokusohet tek përdorimi instrumenteve nga të cilat rritet mbështetja për grupet më të cenueshme, si dhe grupi i tretë që kërkon të kombinohen këto të dyja.

Deri më tani, përmes subvencionimit direkt, Qeveria e Kosovës ka targetuar vetëm grupet më të cenueshme, përveç subvencionimit të tarifave të energjisë elektrike, të cilat ndonëse kanë qenë progresive, nga to kanë përfituar të gjithë konsumatorët. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), rreth mënyrës së ndërhyrjes të shteteve, politikat e vëna në fuqi duhet të zbatohen me kohë, të jenë të targetuara, si dhe të përkohshme.<sup>14</sup> Argument shtesë këtu është se ndihma dhe lehtësimet për grupet e cenueshme e nxisin më pak kërkesën agregate krahasuar me lehtësimet tatimore të vlefshme për të gjithë qytetarët apo kontrollit të çmimeve.<sup>15</sup>

Shtete të ndryshme kanë aplikuar qasje të ndryshme sa i përket kontrollit të inflacionit. Sipas një raporti të FMN, nga 130 shtete të anketuara, rreth 40 kanë ndërhyrë në reduktimin e normave tatimore në konsum të energjisë elektrike dhe ushqime, 30 shtete kanë vënë çmime tavan ose i kanë subvencionuar ato, 20 shtete kanë reduktuar normat në të ardhurat personale, rreth 17 shtete kanë ndarë subvencione për sektorë specifik, ndërkaq, një numër më i vogël i shteteve kanë ndarë edhe kupona ushqimorë, kanë vënë ndalesa për eksport të mallrave strategjike, etj.<sup>16</sup>

Ky raport analizon të metat dhe përparësitë e praktikës së kontrollit të çmimeve, konkretisht efektet e rregullimit të çmimit të naftës në Kosovë, ndërhyrjet e deritanishme të Qeverisë së Kosovës për të luftuar inflacionin, ndikimin e ndryshimit të mundshëm të disa normave tatimore, si dhe vë në pah disa politika tjera përmes të cilave Qeveria do të mund të nxiste një zhvendosje të konsumit të energjisë elektrike për ngrohje tek burimet tjera alternative. Meqë Kosova nuk disponon me instrumente monetare për të ndikuar në kërkesën agregate, fokusi i këtij raportit mbetet vetëm tek krahasimi i mundësive që ndërliken me politikat fiskale.

<sup>12</sup> Shkurtesë në anglisht për: Organization of the Petroleum Exporting Countries

<sup>13</sup> Financial Times. Burimi: <https://on.ft.com/3DTJFar>

<sup>14</sup> FMN. Burimi: <https://bit.ly/3qzOwi0>

<sup>15</sup> FMN. Surging Energy Prices in Europe in the Aftermath of the War: How to Support the Vulnerable and Speed up the Transition Away from Fossil Fuels. Burimi: <https://bit.ly/3BAdZ7u>

<sup>16</sup> FMN. Burimi: <https://bit.ly/3xiIMCG>

## 2. Kontrolli i çmimeve të produkteve

Nga muaji mars i vitit 2022, Qeveria e Kosovës ka zbatuar kohë pas kohe kontrole të ndryshme në çmimet e produkteve të naftës. Tani po synon që përmes Ligjit për masat e përkohshme të produkteve themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg, ta zgjerojë ndërhyrjen në treg duke kontrolluar edhe çmimet e produkteve bazë të cilat kanë pësuar rritje të ndjeshme muajve të fundit. Këtë ligj Qeveria e ka aprovuar<sup>17</sup> dhe dorëzuar për votim në Kuvendin e Kosovës pa ndjekur procedurat e konsultimit publik. I njëjti ka kaluar në lexim të parë në Kuvend me datën 27 tetor 2022 dhe në lexim të dytë më 8 nëntor 2022.<sup>18</sup>

Përmes ligjit, Qeveria e Kosovës synon që në raste madhore të mund të ndërhyjë përmes masave të përkohshme dhe të rregullojë sasinë e lejuar për shitje tek konsumatorët, ndalimin nga shitja të një produkti, caktimin e marzhës së fitimit dhe rrjedhimisht edhe çmimin maksimal të lejuar, të përcaktojë nivele të stokut që duhet të mbahen nga operatorët, të ndalojë eksportet, etj. Rastet kur mund të ndërhyhet përmes këtij ligji janë ato kur ka mungesë të vazhdueshme në treg të produkteve bazë, mospërshtatje të çmimeve vendore me lëvizjet e theksuara të çmimeve në berzë, dallime të mëdha mes çmimeve vendore dhe atyre në vendet fqinje dhe raste tjera të arsyetuara me vendim ekzekutiv. Ligji rendit 14 grupe të produkteve bazë që mund të kenë rregullim të çmimeve, duke përfshirë: drithërat, miell gruri, bukën, orizin, pastat, vajin ushqimor të lulediellit, qumështin, kripën e kuzhinës, vezë pule, mishin e pulës, sheqerin kristalor, produktet e higjienës personale, lëndët e drurit për djegie. Por, me vendim të Qeverisë, mund të përfshihen dhe produkte tjera të ngjashme.

Tek mënyra e përlogaritjes së marzhës së fitimit për operatorët, ligji përcakton se në llogaritje duhet të merren parasysh edhe kostot tjera të zhdoganimit të mallrave përveç obligimeve tatimore.

Vendosja e masave të përkohshme në një seri produktesh është praktikë që është zbatuar nga shumë shtete dhe vazhdon të zbatohet ende në disa prej tyre. Në vitet e '70-ta, në ShBA ishin vendosur çmime tavan për të gjitha produktet dhe pagat. Në disa nga fazat e zbatimit të kontrollit të çmimeve, forma e ndërhyrjeve kishte pësuar ndryshime dhe ofronte fleksibilitet më të madh për bizneset se sa në fazën fillestare. Një praktikë e tillë gjithëpërfshirëse kishte shkaktuar dëme të ndryshme në ekonomi, duke përfshirë ndalim të veprimtarive, mungesë të furnizimit në treg, dhe menjëherë pas heqjes së kufizimeve, shkalla e inflacionit ishte rritur përsëri.<sup>19</sup> Në një shkallë më të kufizuar, Argjentina zbaton politika të tilla në vazhdimësi. Në periudhën 2007–2015, në Argjentinë ishin aplikuar një sërë fazash të kontrollit të çmimeve, ku ato ishin aplikuar në vetëm produktet më me peshë të shportës bazike të konsumit. Më 19 tetor 2021, Argjentina fiksoi për tre muaj çmimet e 1,432 produkteve.<sup>20</sup>

Studimet tregojnë që efektet e kontrollit të çmimeve nuk ishin domethënëse, qoftë kontrolli i plotë apo selektiv i çmimeve. Në rastin e Argjentinës, ndikimi në uljen e çmimeve ishte rreth 0.84% në muajt kur kontrolli ishte në fuqi, ndërsa rritja e çmimeve menjëherë pas heqjes së kontrollit ishte mbi 4.9 pikë përqindje.<sup>21</sup> Një gjetje tjetër ishte se nuk kishte mungesë në furnizim të produkteve me çmim

17 Qeveria e Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3SH8uv8>

18 Kuvendi i Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3DwkMQJ>

19 Hugh Rockoff et al. Drastic Measures: A History of Wage and Price Controls in the United States.

Burimi: <https://bit.ly/3EB0QOP>

20 The Economist. Argentina's government has fixed the price of 1,432 products. 30 tetor 2021.

Burimi: <https://econ.st/3fTIRYQ>

21 Aparicio dhe Cavallo. Targeted price controls on supermarket products. Burimi: <https://bit.ly/3LKSKoh>

të kontrolluar, përveç në një rast kur shteti kishte shpallur ngrirje të plotë të të gjitha çmimeve të konsumit. Po ashtu, në periudhat me çmime të kontrolluara, bizneset rritën numrin e produkteve të ngjashme në treg, të cilat nuk kishin çmim të kontrolluar, e të cilave ua rritën edhe çmimet dhe kishin tendencë t'i plasenin në treg si produkte më kualitative se ato me çmime të rregulluara.

Një masë të tillë të kontrollit të çmimeve, Kosova e ka filluar tek produktet e naftës, fillimisht përmes një vendimi që gjeti zbatim në periudhën 3 mars – 31 maj 2022, e që përcaktonte se marzha maksimale për shitësit me shumicë të naftës të jetë 4%, ndërsa për ata me pakicë 6%. Mirëpo, nga 27 qershori, Qeveria e kishte vënë në zbatim një udhëzim administrativ (UA1) që siguronte një monitorim më adekuat rreth përshtatjes së furnizuesve dhe shitësve të naftës me rregullin që kufiri maksimal i fitimit të shitësve me shumicë të ishte dy centë, ndërsa i atyre me pakicë në 12 centë.<sup>22</sup> Ngjashëm, në fund të muajit gusht të vitit 2022, Qeveria e kishte nxjerrë udhëzimin e dytë administrativ (UA2) me radhë, i cili i vë kufijtë e njëjtë me atë të parin, dhe i njëjti ka gjetur zbatim nga data 1 shtator.<sup>23</sup>

Mes periudhave kur Qeveria kishte vënë rregulla dhe monitorim më të madh për çmimet e produkteve të naftës, ishin disa periudha përgjatë të cilave tregu ishte i parregulluar. Më poshtë kemi analizuar zhvillimet tek nafta gjatë kontrollit të marzhës së fitimit, meqë e njëjta përbën rreth 85% të sasisë së konsumuar të produkteve të naftës në vit në Kosovë.

**Tabela 1.** Vendimet dhe Udhëzimet Administrative në fuqi

Periudha	Marzha e fitimit
3 mars – 31 maj	4% me shumicë, 6% me pakicë
25 qershor – 25 korrik – Udhëzimi Administrativ 1, zbatimi efektiv: 27 qershor – 24 Korrik	2 centë me shumicë, 12 centë me pakicë
30 gusht – Udhëzimi Administrativ 2, zbatimi efektiv: nga 1 shtatori	2 centë me shumicë, 12 centë me pakicë

Në kohën sa ishte në fuqi vetëm vendimi i Qeverisë që marzha e fitimit të shitësve të naftës<sup>24</sup> me shumicë të jetë 4% ndërsa e atyre me pakicë 6% (1 mars–31 maj 2022), për periudhën për të cilën Agjencia e Statistikave të Kosovës ofron të dhëna, vërehet një lëvizje e sinkronizuar dhe pa dallime shumë të mëdha mes çmimeve të naftës në berzë dhe atyre në Kosovë. Gjetjet e këtij raporti tregojnë se të dy çmimet kanë lëvizur në drejtimin e njëjtë, në këtë rast kur njëra është rritur/ulur është rritur/ulur edhe tjetra, dhe që marrëdhënia mes dy variablave është e fortë.<sup>25 26</sup>

Mirëpo, të dhënat e Doganës së Kosovës tregojnë se marzha mesatare e fitimit<sup>27</sup> prej rreth 9.3% e realizuar në këtë periudhë, nëse e karahsojmë çmimin e importuar me atë të shitjes me pakicë, del se ishte më e lartë se kufiri prej 6%. Arsye për këtë është forma e zgjedhur e zbatimit të kësaj politike, ku nuk kishte monitorim strikt dhe

22 Zyra e Kryeministrit të Kosovës. UA për rregullimin e çmimeve të naftës dhe karburanteve të ripërtërishe dhe masat e tjera. Burimi: <https://bit.ly/3qZd6As>

23 Koha.net. Burimi: <https://bit.ly/3Uqngz>

24 Importuesit/furnizuesit kryesor të naftës në Kosovë janë njëherës edhe ndër shitësit kryesorë me pakicë.

25 Koeficienti i korrelacionit mes seteve të të dhënave për këtë periudhë është 0.79. Një shifër prej 1 e korrelacionit do të tregonte një marrëdhënie tejet të fortë mes dy variablave dhe plotësisht pozitive. Edhe përdorimi i vlerave lagged për një apo disa ditë tek variabla a çmimeve me pakicë, meqë në këtë periudhë monitorimi dhe metodologjia për përcaktimin e çmimit ishte jo aq strikte, nuk jep rezultate shumë ndryshe.

26 Një rezultat të njëjtë e konfirmon dhe t-testi, rezultati i të cilit tregon se nuk mund të bie hipoteza se ndryshimi i çmimeve ditore të naftës në berzë dhe në Kosovë në këtë periudhë dallon

27 Mënyra e llogaritjes së marzhës në këtë rast është dallimi mes çmimit mesatar me pakicë dhe atij të furnizimit bazuar në të dhënat e Doganës së Kosovës. Tek vlera e mallrave e paraqitur nga Dogana e Kosovës përfshihet dhe kosto e transportit, si kosto më e madhe, andaj marzha e kalkuluar në këtë formë nuk përfshin vetëm shpenzimet tjera të importuesve të naftës për zhdoganim apo ndonjë shpenzim administrativ. Si e tillë, dallimi mes çmimit me pakicë dhe atij të furnizimit që përfshinë vlerën e mallrave, koston e transportit, obligimet tatimore (doganë dhe akcizën) është një indikator tejet i përafërt i marzhës aktuale të fitimit.




ishite e pamundur që qytetarët ta dinin dhe lajmëronin nëse çmimi i shitjes nuk ishte konform vendimit të Qeverisë. Si rrjedhojë, naftëtarët kishin hapësirë të tejkalonin përbindjen e lejuar të marzhës së fitimit.

Edhe me hyrjen në fuqi të UA1, ku ishin shtuar edhe mekanizmat monitorues dhe raportues për përfilljen e rregullave të përcaktuara brenda tij, vërehet një lëvizje e sinkronizuar e çmimeve por edhe ndjekje me e përafërt e normës së marzhës së përcaktuar. Gjatë periudhës sa ishte në fuqi UA1, çmimi tavan i produkteve të naftës publikohej çdo ditë për publikun dhe vllente në nivel vendi. Kjo e bëri më të lehtë monitorimin meqë qytetarët dhe mediat mund të raportonin për rastet kur ndonjë biznes e tejkalonte çmimin tavan përcaktuar për atë ditë. Zhvillimet në berzë, ku periudha 27 qershor-24 korrik u karakterizua me rënie të ndjeshme të çmimeve, bënë që edhe çmimet me pakicë në Kosovë të bien.

Një gabim që mund të bëhet në interpretimin e çmimeve gjatë kësaj periudhe është pikërisht ky ku bëhet inferencë se për shkak të Udhëzimit Administrativ (UA1) kanë rënë ndjeshëm çmimet e naftës në Kosovë. Bazuar në zhvillimet në tregun e naftës në Kosovë në vitin 2022, del se ndikimi direkt i udhëzimit administrativ UA1 në uljen e çmimit të naftës ishte rreth 6 centë në litër.<sup>28</sup> Në muajt janar-shkurt, kur nuk kishte kontrollim të çmimeve, naftëtarët kishin realizuar marzhë të fitimit prej 18 centë në litër, që ishte më e ulët se marzha e realizuar përgjatë vitit 2021; që mund të jetë një reagim i importuesve të naftës në mënyrë që të mos rritet ndjeshëm çmimi final me pakicë. Arsyeja pse në Kosovë kishte rënie të çmimeve të naftës deri 22 centë në litër gjatë zbatimit të UA1 është se ajo ka koiciduar me rënie të vazhdueshme të çmimeve të naftës në berzë siç vërehet dhe në figurën më poshtë.

**Figura 3.** Indeksi i çmimit të naftës në berzë (28 mar=100)



Mirëpo, monitorimi më rigoroz i tregut nga institucionet ka bërë që lëvizja e çmimeve në berzë të reflektohet shumë më shpejtë në tregun tonë, të cilin e tregon dhe koeficienti i korrelacionit mes çmimeve vendore të naftës dhe atyre ndërkombëtare.<sup>29 30</sup>

<sup>28</sup> Zakonisht krahasimet në këtë raport bëhen me marzhën e shitësve me pakicë dhe jo atë të furnizimit, meqë importuesit kryesorë në Kosovë kanë dhe pikat kryesore të shitësve me pakicë.

<sup>29</sup> Koeficienti i korrelacionit në këtë rast ishte 0.67, ndonëse për këtë matje kishte një numër më të vogël observimesh në dispozicion krahasuar me periudhën e vendimit për kontrollim të çmimeve.

<sup>30</sup> Ngjashëm edhe t-testi, i paraqitur në Tabelën 10 në ankes, tregon se statistikisht nuk mund të thuhet se ndryshimi në çmimet ditore të naftës në berzë dhe në Kosovë dallon.

**Figura 4.** Lëvizja e çmimeve të naftës me pakicë në Kosovë dhe asaj të papërpunuar në berzë, 28 mars – 19 shtator 2022



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e ASK dhe Yahoo

Po ashtu, gjetjet tregojnë se me përfundimin e periudhës së zbatimit të vendimit të Qeverisë, marzha mesatare e fitimit ishte ngritur nga 16 në 18 centë për litër. Ngjashëm, pas përfundimit të zbatimit të UA1, marzha e fitimit ishte ngritur nga 15 në 18 centë për litër. Edhe korrelacioni mes çmimeve të naftës në berzë dhe në Kosovë në periudhat e parregulluara del të jetë negativ ose tejet i ulët. Pra, në secilën periudhë kur nuk kishte ndonjë rregull në fuqi për kontrollimin e çmimeve, tendenca ishte që marzha e fitimit të rritej menjëherë. Një gjetje tjetër, ngjashëm sikur në rastin e Argjentinës kur ishin aplikuar kontrole të targetuara të çmimeve, edhe në Kosovë nuk është vënë re mungesa e furnizimit të produkteve të naftës.

Një ndikim negativ tek çmimet e naftës në Kosovë gjatë kësaj periudhe e kishte dhe zhvlerësimi i euros karshi dollarit mbi 10%, meqë nafta kuotohet në dollarë. Andaj, kjo e ka vështirësuar edhe me tej gjendjen meqë një rritje e tillë e papritur është goditje e madhe tek pjesa e kostos së produktit dhe ndikon drejtëpërdrejt në çmimin final, etj.

— USD/EUR (majtas)  
— ASK nafta (majtas)  
— Nafta (djathtas)

**Figura 5.** Marzha mesatare e fitimit të furnizuesve me naftë



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Doganës së Kosovës dhe ASK

Përdorimi i kontrollit të çmimeve të naftës si praktikë në Kosovë kryesisht ka efekt në uljen e çmimit në nivelin e marzhës së tavanit të vënë nga rregullat e adaptuara. Rritja e numrit të produkteve me çmime të kontrolluara, duke përfshirë edhe produktet tjera nga shporta bazë e konsumit pritet të ketë zhvillime të njëjta. Efekti negativ i masave të tilla ndikohet në masë të madhe nga kohëzgjatja e tyre, varësisht se sa Qeveria synon ta përdorë atë si instrument, si dhe kohëzgjatjes së inflacionit. Rregullimi i çmimeve për produkte bazike ushqimore dhe naftës në Kosovë ndikon një treg i cili në vitin 2021 ka qarkulluar mbi 1.1 miliard euro apo rreth 15% e Bruto Produktit Vjetor të atij viti.<sup>31</sup> Me rritjen e trysnisë së anës së shpenzimeve, veçmas për bizneset e vogla, me marzhën e fitimit të përcaktuar, kontrolli i çmimeve mund të shkaktojë mbylljen e disa bizneseve. Ngjashëm, nga zbatimi i kontrolleve të çmimeve në shtete tjera janë vërejtur tendenca të uljes së cilësisë së produkteve me çmim të kontrolluar, rënie drastike të prodhimit ku fitimi është i ulët mirëpo të cilat mund të jenë sektorë me rëndësi për ekonominë, sikurse rasti me rënien e prodhimit të mishit në Amerikë në vitet '70, etj.<sup>32</sup>

Në disa shtete, sikurse në Francë, Australi, Britani të Madhe etj., për t'i paraprirë një mundësie të ndërhyrjes së shtetit qoftë tek çmimet apo duke i rritur normat tatimore, por edhe për tu dalë në ndihmë qytetarëve, vërehen praktika ku rrjete të mëdha supermarketesh kanë vënë në mënyrë vullnetare çmime tavan për qindra produkte bazike apo në ato më të shitura ndër muaj. Ngjashëm, të njëjtat po tentojnë edhe t'i ulin çmimet për shumë produkte, gjë që ndikon dhe marzhën e tyre të fitimit.<sup>33</sup>

<sup>31</sup> Kalkulim i Institutit GAP nga të dhënat e hapura të Doganës së Kosovës.

<sup>32</sup> Hugh Rockoff et al. Drastic Measures: A History of Wage and Price Controls in the United States. Burimi: <https://bit.ly/3EB0QOP>

<sup>33</sup> Reuters dhe Retail Wire. Burimi: <https://reut.rs/3S94JOW> dhe <https://bit.ly/3S8EKac>

### 3. Ndërhyrja e Qeverisë së Kosovës për të luftuar inflacionin

Për të zbutur ndikimin e inflacionit, Qeveria e Kosovës ka bërë dy ndërhyrje me pako më të mëdha, të cilat kryesisht kanë targetuar familjet dhe qytetarët më të ndikuar nga kriza. Pako e parë e Qeverisë kishte vlerë 100 milionë euro. Masat kryesore të saj parashihnin ndarjen e njëhershme prej 100 eurove për të gjithë punonjësit e sektorit privat dhe publik me të hyra mujore bruto deri në 1.000 euro, 100 euro për studentët dhe pensionistët, dyfishimin e asistencës sociale për muajin prill, si dhe ndarjen e pakove ushqimore. Asistenca sociale ishte dyfishuar më herët edhe për muajt nëntor dhe dhjetor të vitit 2021, pikërisht për shkak të rritjes së kostos së jetesës.<sup>34</sup> Krahas kësaj pakoje, ishte rritur ndjeshëm edhe subvencionimi i kulturave kyçe në bujqësi, të cilat gjithashtu janë ndër burimet kryesore të krizës aktuale botërore me çmime, si dhe subvencionimi i naftës për bujqit në vlerë 36 centë në litër.<sup>35</sup>

Në shtator të këtij viti, Qeveria ka prezantuar dhe pakon e dytë për përballje me inflacionin me vlerë të synuar prej 150 milionë. Përmes kësaj pakoje, parashihet që të ketë ndarje të njëhershme prej 100 euro për pensionistët, nga 100 euro për studentët për muajin nëntor, dhe dyfishim të asistencës sociale për një muaj. Ndërkaq parashihet edhe shtesa mujore prej 50 euro për punonjësit e sektorit publik deri në fund të vitit, dhe një shtesë e njëhershme prej 100 euro për punonjësit e ndërmarrjeve publike. Për punonjësit e sektorit privat, Qeveria zotohet të mbulojë subvencionimin e rritjes së pagave në tre muajt e parë deri në 50% apo maksimum 100 euro.<sup>36</sup> Por, në kuadër të kësaj shume përfshihet edhe masa për nxitje të kursimit të energjisë elektrike dhe kompensimi për normën e inflacionit për projektet kapitale në sektorin publik.

#### 3.1 Masat e Qeverisë për energjinë elektrike

Janë edhe disa masa shtesë të ndërmarra nga Qeveria për të parandaluar rritjen e madhe të çmimit të energjisë elektrike dhe peshës së komponentës së energjisë tek shpenzimet e qytetarëve. Fillimisht, gjatë muajit shkurt të këtij viti, Qeveria kishte zotuar 90 milionë euro për të subvencionuar tarifat e energjisë elektrike, në mënyrë që të njëjtat të mos ndryshojnë për bizneset, si dhe rritja për tarifat e qytetarëve të jetë e përshkallëzuar, ku për nivele të caktuara të konsumit nuk ka pasur fare rritje të tarifave as për këtë kategori. Qeveria ka ndarë edhe rreth 30 milionë euro për Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) për të importuar energji elektrike.<sup>37</sup>

Po ashtu, gjatë muajit shtator të vitit 2022, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim i cili synon ulje të shpenzimit të energjisë nga institucionet publike, duke kërkuar përdorim të vogël të kondicionerëve të ajrit, ndërrim të poçave jo-efiçientë me ata efiçientë, ngrohje të ambienteve gjatë dimrit në maksimum 19 gradë, etj.<sup>38</sup> Vendime të ngjashme do të ishte adekuate të merreshin edhe më herët edhe për sektorin privat, ku konsumi i energjisë elektrike është më i lartë, siç kanë bërë shtete të ndryshme në Evropë, duke përfshirë këtu se deri në cilën orë mund të mbahen të ndezura dritat dhe emrat e ndriçuar (reklammat) të bizneseve.

34 Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3ylu7sV>

35 Kallxo.com. Burimi: <https://bit.ly/3MkeNIN>

36 Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3Cf1bUj>

37 Kallxo.com. Burimi: <https://bit.ly/3V8o2cL>


38 Qeveria e Kosovës. Vendimi nr. 28/96. Burimi: <https://bit.ly/3qYo3Cp>

Në kuadër të pakos së dytë për të luftuar inflacionin është paraparë edhe subvencionimi i faturave të energjisë elektrike në masën prej 20% në rast se konsumi për atë muaj ulet për 10% krahasuar me vitin paraprak.<sup>39</sup> Kurse, gjatë muajit shtator të këtij viti, Qeveria ka marrë vendim edhe për ndalimin e përkohshëm të eksportit dhe ri-eksportit të produkteve të drurit si lëndë djegëse.<sup>40</sup>

Me 6 tetor 2022, Ministria e Ekonomisë (ME) ka prezantuar edhe një masë me vlerë prej 6 milionë euro, ku qytetarëve do t'u subvencionohet blerja e paisjeve eficiente, sikurse e pompave termike, por dhe e paisjeve që operojnë me inpute tjera, sikurse me pelet, dru dhe briket.<sup>41</sup> Kjo thirrje publike u mbyll pas vetëm gjashtë ditësh, pasi ME informoi se brenda kësaj periudhe kishin aplikuar 5.992 përfitues potencial dhe shuma e paraparë buxhetore nuk mjaftonte edhe për aplikuesit tjerë.<sup>42</sup> Duke marrë parasysh se në Kosovë, sektori rezidencial shpenzon mbi 61% të energjisë elektrike të konsumuar gjatë vitit<sup>43</sup>, një shumë e tillë është e pamjaftueshme për të ndikuar ndjeshëm në konsum, si dhe lënia jashtë e përkrahjes për izolim të shtëpive e bën ndikimin e kësaj mase dhe më të kufizuar.

Viteve të fundit, për shkak të çmimeve të ulëta të energjisë elektrike, shumë familje e përdorin energjinë elektrike si burimin e vetëm edhe për ngrohje. Po ashtu, në Kosovë, vetëm 17% e shtëpive përlllogaritet të kenë izolim adekuat të mureve dhe kulmit.<sup>44</sup> Andaj, tek ky sektor është potenciali më i madh për kursimin e energjisë elektrike. Këtë e konfirmon dhe fakti se koha e pikut të konsumit të energjisë elektrike është gjatë natës, pra kur sektorët prodhues janë thuajse tërësisht të mbyllur.

**Figura 6.** Kërkesa për energji elektrike nga totali i faturuar



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e ZRRE

Tek krizat si kjo me rritjen e çmimit të energjisë elektrike dhe disa produkteve bazë, shtetet po ashtu po tentojnë që ndërhyra të targetojë edhe burimin e krizës. Kjo kryesisht ka të bëjë me rritjen e kapaciteteve të prodhimit të brendshëm, si të energjisë elektrike, por edhe të produkteve tjera bazike ushqimore. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përmes pakos për uljen e inflacionit, po subvencionohen burimet e ripërtrishme të energjisë, qoftë me instalimin e paneleve solare nga familjet dhe bizneset, instalimin e pompave termike, instalimin e 120 mijë turbinave me erë, etj.<sup>45</sup>

Furnizimi me energji elektrike përgjatë dimrit në Kosovë do të ketë sfida të mëdha. Trajektorja e konsumit gjatë dimrit në Kosovë dallon dukshëm nga mesatarja vjetore, ku konsumi mbetet në një nivel të lartë përgjatë një periudhe më të madhe gjatë ditës (shih Figurën 7). Diskrepanca e madhe mes konsumit të energjisë elektrike dhe prodhimit gjatë dimrit do ta bëjë tejet të vështirë mbulueshmërinë e përgjithshme të konsumit. Deri në 600 MWh/h dallim mes

39 Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3Cf1bUj>

40 Qeveria e Kosovës. Vendimi nr. 06/97. Burimi: <https://bit.ly/3BXOUF0>

41 Ministria e Ekonomisë. Burimi: <https://bit.ly/3e9Dfd0>

42 Faqja zyrtare e ME në Facebook, 12 tetor 2022. Burimi: <https://bit.ly/3yAZwYe>

43 Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Raporti vjetor 2021. Burimi: <https://bit.ly/3qZGQxe>


44 RIT Center for Energy and Natural Resources. Energy consumption and Potentials for Energy Efficiency Implementation: Analyzing Low Income, Low Service Areas of Kosovo – Final Report. Source: <https://bit.ly/3MEmi6y>

45 The White House. Burimi: <https://bit.ly/3COLX6s>

kërkesës për konsum dhe prodhimin, për periudha mbi tetë orëshe gjatë ditës janë thuajse të pa përballeshme që të importohen, duke marrë parasysh çmimet enorme të energjisë elektrike në tregje, ku në raste, kuotimet e kontratave për të drejtat e ardhshme (futures/forwards) kanë arritur deri në 1,050 euro/MWh.<sup>46</sup>

Në anën tjetër, një ndër problemet me subvencionimin e çmimeve të energjisë është se ato e mbajnë në mënyrë artificiale konsumin e lartë.<sup>47</sup> Përkundër një efekti pozitiv të natyrës progresive së tarifave në uljen e konsumit, pragu deri në 800 kWh për amvisëritë nuk ka pësuar ndryshime në tarifa dhe i njëjti mbetet tejet i lartë meqë gjatë dimrit vetëm 31% e familjeve shpenzojnë mbi 600 kWh në muaj.<sup>48</sup> Përveç gjetjes së mundësive për zëvendësim të konsumit të energjisë elektrike dhe krahas masës nxitëse të Qeverisë për kursim të energjisë elektrike, sikur edhe në shtetet tjera, rritja e konsumit dhe çmimet e larta të importit do të krijojnë presion për rritjen e tarifave të energjisë elektrike. Në rast se ndodhë kjo, atëherë një efekt i tarifave të reja do të ishte dhe në uljen e konsumit të energjisë elektrike.

**Figura 7.** Konsumi dhe prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë në orë, 2021



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e KOSTT

Krahas adresimit të dëmeve afatshkurtëra të shkaktuara nga inflacioni i lartë, Qeveria duhet të synojë dhe adresimin e shkaqeve të brendshme të një norme kaq të lartë të inflacionit. Më lartë u theksua se shtetet me kapacitete më të larta prodhuese në vend, janë duke pasur norma më të ulëta të inflacionit. Në këtë pikë, politikat qeveritare për zhvillimin e industrive dhe prodhimin të brendshëm janë tejet të rëndësishme, meqë aktualisht inflacioni në Kosovë është në shkallë tejet të lartë inflacioni i importuar. Ngjashëm, tek fusha e energjisë, është e rëndësishme të ndërmerren hapa strategjik në rritjen e kapaciteteve prodhuese të energjisë, dhe prioritizimin e investimeve në efikasitet të energjisë, veçmas në sektorin e amvisërisë ku humbjet e energjisë për shkak të izolimeve të dobëta të shtëpive janë të mëdha. Mirëpo, Kosova nuk ka bërë ndonjë nismë të rëndësishme në këtë aspekt, dhe ende nuk e ka të aprovuar as Strategjinë e re të energjisë 2022–2031.

<sup>46</sup> Reuters. Burimi: <https://reut.rs/3LwKyrD>

<sup>47</sup> FMN. Burimi: <https://bit.ly/3R89fvG>

<sup>48</sup> ZRRE. Raport konsultativ: Shqyrtimi i strukturës tarifore për konsumatorët e rregulluar të amvisërive të shërbyer nën fshu. Burimi: <https://bit.ly/3Mip95H>

### 3.2 Mundësia tjetër (shtesë): ulja e normës së TVSH, akcizës dhe subvencionimi

Në debatin publik në Kosovë, një diskurs i ndjekur është që përveç ndërhyrjeve të deritanishme të Qeverisë, të cilat kanë qenë kryesisht përmes subvencionimit, duhet të bëhen dhe lehtësime tatimore. Në disa raste, disa parti politike e kanë parë si opsion adekuat edhe ndërhyrjen përmes lehtësimeve tatimore dhe politikave më gjithpërfshirëse.<sup>49</sup>

Ndërmarrja e politikave të tilla alternative që parashohin lirime tatimore në produktet e energjisë dhe atyre ushqimore do të kishin kosto buxhetore shtesë rreth 246 milionë euro në gjashtë muaj apo rreth 455 milionë euro në vit. Nëse ndërhyrja do të ishte vetëm për një periudhë gjashtë mujore, si kosto ajo ka peshë sa rreth 7.7% e shpenzimeve vjetore të Qeverisë gjatë vitit 2022 apo rreth 8.3% të shpenzimeve vjetore të buxhetit të projektuar për vitin 2023; në rast se masat e tilla do të gjenin zbatim nga viti tjetër.

**Tabela 2.** Ndikimi buxhetor i disa lirimeve tatimore

	Kosto buxhetore për një periudhë gjashtë mujore	Kosto buxhetore për një vit
Përgjysmim i normës së TVSH-së dhe pezullim i akcizës për naftë, benzinë dhe gaz	150–170 milionë euro	320 milionë euro
Heqja e TVSH-së në pelet	600–700 mijë euro	1.2 milionë euro
Heqja e TVSH-së nga faturat e energjisë elektrike	25–35 milionë euro	58 milionë euro
Heqja e TVSH-së dhe taksës doganore për produktet ushqimore të importuara	min. 30–40 milionë euro	75 milionë euro
<b>Gjithsej ndikimi buxhetor</b>	<b>205–246 milionë euro</b>	<b>455 milionë euro</b>

Burimi: Kalkulim i përafërt i Institutit GAP bazuar në strukturën e të hyrave buxhetorë për këto kategori gjatë vitit 2021

Tek përdorimi i normave tatimore si instrumente për të zbutur rritjen e çmimeve, rastet më të shpeshta të zbatuara nga shtetet në Evropë dalin të jenë ato të reduktimit të normës për energji elektrike dhe produktet e naftës që përdoren për ngrohje. Kjo, pasi që në shumë shtete burim kryesor i ngrohjes del të jetë gazi dhe në një masë më të vogël energjia elektrike. Ndërkaq, në Kosovë është e kundërta, veçmas viteve të fundit, ku për shkak të tarifave të ulëta të energjisë elektrike është rritur ndjeshëm përdorimi i energjisë elektrike edhe për ngrohje. Ndërhyrja e qeverive tek sektori i energjisë elektrike, në këtë periudhë cilësohet si vendimtare duke marrë parasysh ndikimet indirekte të këtij produkti.

Shumica nga shtetet të cilat i kanë zvogëluar normat tatimore në produktet e energjisë, e kanë bërë atë për një kohë të caktuar, zakonisht për një periudhë 6 deri 9 mujore. Gjermania e ka ulur TVSH në gaz nga 19% në 7%; Sllovenia e ka ulur TVSH në gaz, energji elektrike dhe karburant për ngrohje nga 22% në 5%; Belgjika TVSH-në në energji elektrike, gaz dhe ngrohje nga 21% në 6%; Spanja TVSH-në për energjinë elektrike të prodhuar brenda vendit nga 21% në 10%; Turqia TVSH-në në energji elektrike të prodhuar brenda vendit nga 18% në 8%, etj. (shih Tabelën 1 në aneks). Në rastin e Kosovës, Qeveria ka zgjedhur si instrument subvencionimin direkt të tarifave të energjisë elektrike, duke ndarë rreth 90 milionë euro për to nga buxheti. Kjo ka ndikuar që rritja e tarifave të jetë më e vogël se sa dinamika e çmimeve në këtë sektor. Specifikisht, subvencionimi ka bërë që të mos ketë fare rritje të tarifave për bizneset, që në një shkallë ka ndikuar edhe në një trend më të ulët të rritjes së

<sup>49</sup> Koha.net. PDK-ja me pesë propozime për dalje nga kriza ekonomike. Burimi: <https://bit.ly/3SVl0aI>. Avdullah Hoti, deputet nga LDK. Burimi: <https://bit.ly/3SSDE2G>

çmimeve të produkteve tjera në treg. Ngjashëm janë subvencionuar pjesshëm edhe tarifatat për konsumatorët shtëpiakë.

Shtete sikurse Gjermania dhe Britania e Madhe kanë bërë edhe subvencionim direkt të qytetarëve me shuma fikse. Gjermania ka ndarë nga 300 euro për studentët dhe pensionistët, ndërkajq Britania e Madhe është duke u dhënë secilës familje zbrjrite në faturat e energjisë elektrike prej 400 funtave.<sup>50</sup>

Kosova, nga rreth 2.2 miliardë të hyra buxhetore sa i kishte në vitin 2021, pa përfshirë pranimet tjera buxhetore nga kredimarrja, rreth 1 miliard euro apo 48% i ka të hyra nga TVSH dhe rreth 500 milionë euro apo 23% nga akciza. Ndërkajq, edhe për shkak të rritjes së inflacionit, performanca e të hyrave buxhetore është tejte më e mirë këtë vit. Vetëm në periudhën janar-gusht 2022 është mbledhur TVSH sa 75% e tërë TVSH-së të mbledhur në vitin 2021, ndërkajq është tejkaluar për 8% shuma e mbledhur gjatë vitit 2021 nga tatimi në të ardhurat e korporatave, reth 67% e akcizës, etj.<sup>51</sup>

### 3.3 Lirimet e propozuara tatimore për produktet e naftës dhe energjisë

Në shumë shtete të Evropës, gazi del të jetë burimi kryesor i ngrohjes. Po ashtu, për dallim nga Kosova ku norma e akcizës prej 15 centë në litër ka ndikim në çmim thujse të ngjashëm me normën e TVSH-së prej 18%, në disa shtete të Evropës sikurse Gjermania, Luksemburgu, Belgjika etj., norma e akcizës për gazin e përdorur për ngrohje (nën 7 centë në litër) del të jetë shumë më e vogël se sa norma e TVSH-së. Andaj, edhe heqja e TVSH-së në gaz në këto vende, që po haset si praktikë këtë vit, është më me ndikim. Sa i përket gazit të importuar në Kosovë, sipas legjislacionit në fuqi, ai i përdorur për prodhim lirohet nga akciza, ndërkajq ai për ngrohje dhe zierje jo. Nga të dhënat e Doganës së Kosovës, nga gazi i importuar gjatë vitit 2021, akcizë është paguar për rreth 21 milionë metra kub për të cilat janë paguar rreth 3.2 milionë euro dhe rreth 2.9 milionë euro janë paguar në formë të TVSH-së. Lirimet tatimore të përkohshme në gaz do të kishin një ndikim pozitiv për shkak që e shkarkon në një masë kërkesën për energji, veçmas për zierje dhe për ngrohje. Kjo masë nuk do të kishte ndikim të lartë buxhetor.

Mirëpo, ndikimi buxhetor nga lirimet tatimore për produktet tjera të naftës do të ishte tejte i madh. Konkretisht, për produktet sikurse nafta dhe benzina, në vitin 2021, të hyrat e Kosovës nga TVSH ishin rreth 112 milionë euro, ndërsa nga akciza rreth 283 milionë euro. Në total, të hyrat nga këto dy kategori ishin mbi 395 milionë euro apo rreth 18.1% e të hyrave buxhetore të Kosovës për atë vit. Sikur të bëhej reduktimi i TVSH-së në produktet e naftës nga 18 në 8% dhe pezullimi i akcizës në naftë, kjo do të kishte ndikim në të hyrat buxhetore rreth 150–170 milionë euro në gjashtë muaj apo rreth 300–320 milionë euro në vit.

**Tabela 3.** Vlera e obligimeve tatimore të paguara për produktet e naftës, 2021

2021	Sasia	Vlera e Mallrave	Taksa e Akcizës	Taksa e TVSH-së
Nafta	728,616,744	320,461,969 €	251,651,166 €	100,952,532 €
Benzina	81,438,918	37,123,767 €	31,129,135 €	12,239,506 €
Gazi	49,928,215	14,226,317 €	3,187,588 €	3,130,783 €
Gjithsej	859,983,877	371,812,053 €	285,967,889 €	116,322,822 €

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Doganës së Kosovës

Po ashtu, Qeveria ka marrë vendim edhe për ndalimin e përkohshëm të eksportit dhe ri-eksportit të produkteve të drurit si lëndë djegëse, ku synimi është veçmas

50 Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Burimi: <https://bit.ly/3Snk51H>

51 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). Seritë kohore. Burimi: <https://bit.ly/3sFK75K>



tek ndalimi i eksportit të peletit.<sup>52</sup> Marrë parasysh të dhënat e Doganës së Kosovës për vitin 2021, sikur Qeveria të vendoste të nxiste një grup qytetarësh që të zhvendoseshin nga konsumi i energjisë elektrike për ngrohje tek përdorimi i peletit, ndikimi në të hyrat e Qeverisë nga TVSH, meqë akcizë nuk aplikohet, do të ishte rreth 600 mijë euro në gjashtë muaj apo rreth 1.2 milionë euro në vit. Mirëpo, një politikë e tillë do të kishte efekt vetëm nëse nuk lejohet që zbritja nga ulja e akcizës dhe/ose TVSH të mos reflektojë direkt në çmimin e shitjes.

**Tabela 4.** Vlera e obligimeve tatimore të paguara pelet për ngrohje dhe zierje, 2021

	Vlera e mallrave	Pesha neto	Taksa e Akcizës	Taksa e TVSH-së
Peleti	6,426,500.48 €	47,552,734.00	0.00 €	1,156,770.28 €

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Doganës së Kosovës

Ngjashëm, ka pasur edhe propozime për lirimin e faturave të energjisë nga TVSH. Nga të hyrat e lejuara për KESCO-n e cila i faturon konsumatorët fundorë, bazuar në të hyrat e lejuara, shuma e paguar nga qytetarët në formë të TVSH-së për faturat e energjisë elektrike në vit del të jetë rreth 58 milionë euro. Nga një numër shtetesh në Evropë, të cilat kanë bërë reduktime në normat e TVSH, numri më i madh i tyre kanë aplikuar një reduktim prej 50% deri në 75% të normave aktuale. Në një rast të ngjashëm, ndikimi buxhetor i reduktimit të TVSH-së për energji elektrike në Kosovë nga 8% në zero për një vit pra do të ishte rreth 25–35 milionë euro në gjashtë muaj, apo rreth 58 milionë euro në vit.

### 3.4 Lirimet e propozuara tatimore për produktet ushqimore

Po ashtu, nga importi i produkteve ushqimore<sup>53</sup>, Kosova gjatë vitit 2021 ka mbledhur rreth 104 milionë euro si TVSH dhe rreth 18 milionë euro si taksa doganore. Ndonjë ndërhyrje në uljen e normave tek këto kategori, nëse normat e TVSH-së përgjysmohen nga 18% në 8% apo 8% në zero, si dhe nëse heqet taksa doganore, mund të ketë ndikim buxhetor minimum 30–40 milionë euro në gjashtë muaj apo rreth 75 milionë euro në vit.

**Tabela 5.** Vlera e obligimeve tatimore të paguara për produkte ushqimore, 2021

2021	Sasia	Vlera e Mallrave	Taksa e Doganës	Taksa e Akcizës	Taksa e TVSH-së
HS Kodi 01-21	12,492,529	738,913,379 €	17,791,346 €	0 €	104,333,347 €

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Doganës së Kosovës

Nëse do të aplikoheshin lirime të tilla tatimore sikur këto më lartë, ndikimi i tyre buxhetor do të ishte rreth 225–266 milionë euro për gjashtë muaj, në rast se vendimi do të ishte i përkohshëm sikur në vendet tjera, ose rreth 480 milionë euro në vit. Mirëpo, praktika të tilla gjithpërfshirëse, ku nuk bëhet një targetim i grupeve të cenushme, e rrisin konsumin në mënyrë artificiale. Si rrjedhojë, edhe efekti i ndihmës është më i vogël.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe është sugjeruar edhe rritja e pagës minimale<sup>54</sup>, të cilën ndonëse Qeveria e kishte propozuar si politikë adekuate në këtë periudhë inflacioni, e njëjta nuk ka kaluar ende në Kuvend në lexim të dytë. Po ashtu, është propozuar dhe lejimi i tërheqjes së mjeteve nga Trusti pensional.<sup>55</sup>

<sup>52</sup> Qeveria e Kosovës. Vendimi nr. 06/97. Burimi: <https://bit.ly/3BXOUF0>

<sup>53</sup> Produktet ushqimore kryesore në nomenklaturën e Tarifave të Integruara të Kosovës (TARIK) kategorizohen me kodet 01 deri në 21.

<sup>54</sup> Avdullah Hoti. Ish-kryeministër dhe deputet aktual i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3SSDE2G>

<sup>55</sup> Koha.net. PDK-ja me pesë propozime për dalje nga kriza ekonomike. Burimi: <https://bit.ly/3SVI0al>

## Përfundim

Rritja e ndjeshme e çmimeve po e rëndon mirëqenien e familjeve në Kosovë. Në muajt në vijim sfiduese për Kosovën do të jetë dhe furnizimi me energji elektrike, duke marrë parasysh kapacitetet jo të mjaftueshme prodhuese të Kosovës dhe çmimet e larta të importit. Lidhur me situatën e krijuar, Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë disa masa, qoftë duke ndërhyrë përmes pakove financiare, të cilat synojnë kryesisht të ndihmojnë qytetarët më të goditur nga kriza, apo edhe masa tjera për të nxitur kursimin e energjisë elektrike. Njëherësh, Qeveria ka ndërhyrë fillimisht duke kontrolluar çmimet e produkteve të naftës përmes përcaktimit të marzhës së fitimit për shitësit e naftës, ndërsa tani ka Kuvendi ka aprovuar një ligj i cili rregullon çmimet për një numër më të madh të produkteve të shportës bazike.

Praktikat e vendeve të tjera, por edhe rasti i Kosovës me çmimet e kontrolluara të naftës, tregojnë që efekti i kontroleve të çmimeve është i kufizuar vetëm në periudhën sa janë në fuqi rregullat e Qeverisë për kontrollit të çmimit. Kurse, përdorimi i kontrollit të çmimeve si instrument për uljen e inflacionit del të jetë jo-efektiv, meqë pas heqjes së kufizimeve, çmimet kanë tendencë të rriten menjëherë. Mirëpo, në rast se inflacioni është strukturor në ekonomi dhe zgjat, politika të tilla mund të dëmtojnë sektorët e rregulluar, qoftë duke ndikuar në uljen e prodhimit, mbylljen e bizneseve, rënien e cilësisë së produkteve, etj. Andaj, ndonëse masat e kontrollit të çmimeve do të jenë të përkohshme, është e rëndësishme që Qeveria të bëjë analiza të vazhdueshme mbi dëmin potencial të shkaktuar nga kontrolli i çmimeve në sektorët e prekur. Po ashtu, një rrezik me kontrollin e çmimeve mbetet ai që kërkesa në treg mbetet artificialisht e lartë për shkak të çmimeve më të lira se sa në një treg të lirë dhe pa kufizime ku çmimet rregullohen automatikisht nga niveli i kërkesës dhe ofertës në treg. Krahas masave aktuale të Qeverisë për të ndihmuar qytetarët e prekur më shumë nga inflacioni i lartë, është e duhur që të miratohet paga e re minimale e cila do të prekte rreth 106 mijë punonjës të sektorit privat. Njëkohësisht, Qeveria duhet të hartojë dhe zbatojë politika të qëndrueshme për rritje të prodhimit vendor në mënyrë që të ulët varësia nga importi, rrjedhimisht dhe ekspozimi ndaj inflacionit të importuar.

Krahas vendimit të Ministrisë së Ekonomisë për kursim të energjisë elektrike në sektorin publik dhe nxitjes së kursimit të energjisë elektrike nga familjet, Qeveria duhet të marrë vendime për kursimin e energjisë elektrike edhe në sektorin privat, duke ndjekur praktikatat e mira të vendeve tjera. Qeveria duhet në vazhdimësi të ndajë mjete për iniciativat që mbështesin rritjen e efikasitetit në konsum të energjisë në shtëpi, e ku mbi 61% e energjisë elektrike të faturuar gjatë vitit konsumohet nga familjet (amvisëritë). Mungesa e programeve të tilla nga viti 2021, kur kishte sinjale të përkeqësimit të gjendjes me energji elektrike edhe në vitin 2022, bënë që Kosova të mos e targetojë siç duhet njërin nga shkaqet kryesore të konsumit të lartë të energjisë elektrike gjatë dimrit. Po ashtu, marrë parasysh rëndësinë që e kanë për zhvendosjen e burimit të ngrohjes dhe ndikimin jo të madh buxhetor, Qeveria duhet të konsiderojë lirimin nga obligimet tatimore për gazin dhe peletin, çmimet e të cilave parashihet të kontrollohen përmes ligjit të ri, gjë e cila e bënë edhe lirimin tatimor me lehtë efektiv. Ngjashëm, Qeveria duhet të tentojë të zgjidhë dhe burimin e krizës, e që në fushën e energjisë nënkupton ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese. Një hap në këtë drejtim do të ishte miratimi dhe fillimi i zbatimit të Strategjisë së re të energjisë 2022–2031.

# Aneks

**Tabela 1.** Ndërhyrja e shteteve përmes normave tatimore për të lehtësuar rritjen e kostos së jetesës për qytetarët

Vendi	Përshkrimi	Norma e vjetër	Norma aktuale	Deri kur është valide
Gjermania	Ulje e TVSH-së në gaz	19%	7%	Nga 1 tetori 2022 deri më 31 mars 2024
Luksemburgu	Ulje e TVSH-së në naftën që përdoret për punë bujqësore dhe kopshtari, si dhe për naftën industriale:  Ulje e TVSH-së për karburante	17%	14%	6 maj 2022 – fundi korrikut 2022
Sllovenia	Ulje e TVSH në faturat e gazit, energjisë elektrike, karburantit për ngrohje	22%	5%	E konfirmuar nga 1 shtator 2022 deri më 31 maj 2023
Qipro	TVSH me normë zero për benzinën, energjinë dhe energjinë elektrike	19%	0%	14 korrik 2022 deri në fund të vitit
Belgjika	Ulje e TVSH-së në energji elektrike, gaz dhe ngrohje	21%	6%	Fillimisht nga 1 prilli deri në 30 qershor 2022, pastaj është me një vendim të ri është zgjatuar nga 1 korrik deri më 31 dhjetor 2022;  fillimisht nga 1 prilli deri në 30 shtator 2022 pastaj me një vendim të ri është zgjatuar deri më 31 dhjetor 2022.
Spanja	Ulje e përkohshme e TVSH-së për energjinë elektrike të prodhuar brenda vendit	21%	10%	fillimisht nga qershori deri më 31 dhjetor 2021, më pas ajo u zgjat për herë të parë deri në prill 2022, për t'u zgjatuar përsëri deri në qershor 2022
Estonia	Ulje e TVSH-së për benzinë, naftë dhe gazin për ngrohje	20%	5%	nga 30 prill 2022 – xxxx
Holanda	Ulje e TVSH-së për energjinë (gazin natyror, energjinë elektrike dhe ngrohjen qendrore)	21%	9%	1 korrik 2022 – 31 dhjetor 2022
Italia	Ulje e TVSH-së në gaz natyral	10%	5%	fillimisht tetor – dhjetor 2021, pastaj me vendimin e fundit zgjatet deri më 31 dhjetor 2022
Irlanda	Ulje e TVSH-së për faturat e gazit dhe energjisë	13.50%	9%	1 maj 2022 – 31 tetor 2022
Polonia	Ulje e TVSH-së në qymyr, naftë ngrohëse, karburant naftë dhe gaz LPG për ngrohje	23%	8%	1 shkurt 2022 – 31 korrik 2022

Vendi	Përshkrimi	Norma e vjetër	Norma aktuale	Deri kur është valide
Maqedonia e Veriut	<ol style="list-style-type: none"> <li>Ulje e TVSH-së në ushqimin bazik</li> <li>Ulje e TVSH-së në karburante</li> <li>Ulje e TVSH-së në energji elektrike</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>5%</li> <li>18%</li> <li>18%</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>0%</li> <li>10%</li> <li>5% ; 10%</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Nga 17 marsi deri më 31 maj 2022;</li> <li>Nga 12 marsi deri më 31 maj 2022;</li> <li>5% deri më 31 dhjetor, pastaj do shkoj 10% për gjashtëmujorin e parë 2023, për t'u kthyer përsëri në normën standarde.</li> </ol>
Rumania	Ulje e TVSH-së në energjinë e ngrohjes së brendshme (domestic heating energy)	19%	5%	Ka qenë valide nga nëntori 2021 deri në mars 2022
Turqia	Ulje e TVSH-së në energjinë elektrike të prodhuar brenda vendit	18%	8%	28 shkurt 2022 – xx

Burimi: VAT calc (<https://bit.ly/3QP9HzF>)

**Tabela 2.** Korrelacioni mes çmimeve të naftës në berzë dhe aty në Kosovë

Periudha dhe masat	Masat	Korrelacioni
3 mars – 31 maj	Vendimi i Qeverisë	0.79
1 qershor – 24 qershor	E pa rregulluar	-0.43
27 qershor – 24 Korrik	UA 1	0.67
25 korrik – 31 gusht	E pa rregulluar	0.18
Nga 1 shtatori	UA 2	0.62


**Tabela 3.** Kategoritë kryesore të të hyrave buxhetore, 2019-gusht 2022

	2019	si %	2020	si %	2021	si %	Jan-Gusht 2022	si %	Jan-Gusht 2022/2021, si %
TVSH-ja	845,647 €	44.8%	770,145 €	44.7%	1,038,218 €	47.5%	782,521 €	48.1%	75%
Akciza	435,496 €	23.1%	398,072 €	23.1%	501,295 €	23.0%	335,242 €	20.6%	67%
Tatimi në të ardhura personale	165,616 €	8.8%	157,966 €	9.2%	189,521 €	8.7%	141,775 €	7.6%	75%
Tatimi në të ardhura të korporatave	94,593 €	5.0%	85,279 €	5.0%	113,946 €	5.2%	123,555 €	8.7%	108%
Detyrimi Doganor	130,325 €	6.9%	101,618 €	5.9%	124,606 €	5.7%	83,595 €	5.1%	67%
Tatimi në pronë	27,277 €	1.4%	22,707 €	1.3%	36,258 €	1.7%	24,616 €	1.5%	68%


Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e MFPT-së



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.



Instituti GAP përkrahët nga:



**Si ndikon në inflacion kontrolli  
i çmimeve të produkteve?**